



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. 43/2014

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008,
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Pas nenit 115 shtohet neni 115/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 115/1

Dënime lidhur me transferimin e çmimit

1. Në rast të mosparaqitjes në kohë të “Njoftimit të transaksioneve vjetore të kontrolluara”, në përputhje me dispozitat përkatëse të udhëzimit të Ministrit të Financave, “Për transferimin e çmimit”, tatimpaguesi dënohet me një gjobë fikse prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, për çdo muaj vonesë.

2. Në rast rregullimesh të detyrimeve tatimore, për efekt të transferimit të çmimit në bazë të dispozitave të nenit 36, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, tatimpaguesit dënohen sipas nenit 114, “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo kontributit”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Në rast rregullimesh të detyrimeve tatimore, për efekt të transferimit të çmimit, në bazë të dispozitave të nenit 36, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ndaj tatimpaguesve, të cilët kanë plotësuar dhe kanë paraqitur në organet tatimore dokumentacionin e transferimit të çmimit, siç përcaktohet në nenin 36/5, të ligjit të sipërpërmendur, dhe udhëzimin e Ministrit të

Financave, “Për transferimin e çmimit”, këta tatimpagues janë të detyruar të paguajnë vetëm detyrimin shtesë dhe interesat, por jo gjoba.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META

Miraturar në datën 24.4.2014